

Партнерство за  
Отворена  
Власт на  
**Северна  
Македонија**



## **RAPORTIM I PAVARUR:**

Republika e Maqedonisë së Veriut


## **FUSHA PRIORITARE:**

**Qasja te drejtësia**

## **RAPORT PËR IMPLEMENTIMIN:**

tetor 2021 – 19 shtator 2022

Zoran Bikovski, OJQ “KHAM” Dellçevë





Во пресрет на подготовката на петтиот Национален акциски план за Партнерство за отворена власт 2021-2023 година (НАП за ПОВ 2021-2023), се формираше Мрежа на граѓански организации за ПОВ со цел поорганизирано делување и влијание на граѓанските организации на неговото креирање, како и поттикнување и мониторинг на имплементацијата на постојниот и идните акциски планови.

Со цел обезбедена вклученост на граѓанските организации во поддршка и следење на имплементацијата на НАП за ПОВ 2021-2023, Мрежата за ПОВ учествува и придонесува за воспоставување структура за координација и мониторинг на развојот и спроведувањето на НАП за ПОВ 2021-2023 обезбедувајќи независен мониторинг на имплементацијата.

# PËRMBAJTJA



<b>Rezymeja përmbledhëse:</b>	
<b>Republika e Maqedonisë së Veriut -</b>	
Qasja te drejtësia .....	5
<b>I. Hyrja .....</b>	8
<b>II. Implementimi i planit aksional -</b>	
Qasja te drejtësia .....	10
<b>III. Metodologjia dhe burimet .....</b>	18
<b>Aneksi I. ....</b>	19
Pasqyra e implementimit të	
Qasjes te drejtësia .....	19
<b>Aneksi II. ....</b>	23
Burimet/materialet për verifikim .....	23

## LEGGJENDA

PIMPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e Republikës së Maqedonisë së Veriut
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut
NMG	Ndihma minimale e garantuar
MD	Ministria e Drejtësisë
NJP	Ndihma juridike pa pagesë
OQ	Organizatave qytetare
PQH	Partneriteti për qeveri të hapur
BE	Bashkimi Evropian
PNA	Plani nacional aksional
PQH	Partneriteti për qeverisje të hapur
MSHIA	Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë
SHMJR	Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj
FSHHM	Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni
PA	Plani aksional
QPS	Qendra për punë sociale
MPM	Masat e përkohshme për mbrojtje
BEL	Byroja për Ekspertizë Ligjore
LNJP	Ligji për ndihmë juridike pa pagesë
NJR	Njësia rajonale

Ekzemplarin e këtij raporti e përpiloi Darko Antiq nga Shoqëria ESE në bazë të ekzemplarëve të raportit të MRP-së (mekanizmi për raportim të pavarur). Ekzemplari është përpiluar për përgatitje të raporteve, të cilat janë pjesë e procesit për vlerësim dhe monitorim të pavarur të Planit Aksional për PQH të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga përfaqësuesit e organizatave qytetare të cilat janë anëtare të Rrjetit Nacional të OQ-ve për PQH.



Association for emancipation,  
Solidarity and equality  
of women - ESE

# REZYMEJA PËRMBLEDHËSE:

## Republika e Maqedonisë së Veriut - Qasja te drejtësia



Fusha prioritare “Qasja te drejtësia” ka për qëllim t’i mbrojë fëmijët të cilët janë nga kategoritë vulnerable të qytetarëve, nga trajnimi çnjerëzor, që t’i garantojë të drejtat sociale të personave kur janë në rrezik social dhe ta bëjë sistemin e drejtësisë në dispozicion të të gjithëve. Në pjesën më të madhe të angazhimeve shihet një përparim i rëndësishëm, me të cilin institucionet dëshmojnë përkushtim, hapje dhe tregojnë mirëkuptim mbi gjendjet e grupe vulnerable të qytetarëve. Ky raport, përveç përparimit, tregon edhe se ekziston koordinim i dobët dhe se nuk ndikojnë të gjitha institucionet me përkushtim të njëjtë që angazhimet të realizohen deri në fund dhe në kohë. Megjithatë, periodha 2021-2022 është periudhë që u karakterizua nga sfida serioze, si pandemia me covid-19, invazioni ushtarak mbi Ukrainën, kriza energjetike dhe rritja e çmimeve të produkteve ushqimore, që ndikoi, para së gjithash, MPPS-ja ta drejtojë energjinë në lehtësimin e gjendjeve. E gjithë kjo kontribuoi që të mos mbahen rregullisht takimet e grupeve të punës me prani fizike, kështu që në pjesën më të madhe janë mbajtur onlajn. Ekziston përparim në të katra angazhimet që janë pjesë e fushës prioritare “Qasje te drejtësia”, kurse më i madh është në pjesën e profesionalizimit të kuadrit policor dhe sensibilizimit të tij, që përmbahen në angazhimin e parë. Është për t’u përshëndetur hapja gjithnjë dhe më e madhe e MPB-së nëpërmjet pajisjes së 11 hapësirave me regjistrime audio dhe video. Përparim ka edhe në angazhimin për qasje te drejtësia për qytetarët e rrezikuar socialë dhe qytetarët në rrezik social nëpërmjet azhurnimit të listës së përdoruesve të NMG-së nga MPPS-ja, dorëzuar Odës së përmbartuesve, me të cilën parandalohet bllokimi i numrit social. Në këtë mënyrë është zvogëluar theksueshëm numri i personave që janë bllokuar nga përmbartuesit dhe nevojitet vetëm zgjidhje softuerike, kështu që bankat do të bëjnë të pamundur bllokimin e tij. Ekziston një përparim në kuptimin administrativ për angazhimin për gratë që kanë duruar dhunë familjare nëpërmjet përgatitjes së dy akteve nënligjore, të cilat pas miratimit nga Gjykata Supreme do të miratohen nga Ministria e Drejtësisë. Janë emëruar gjykatës dezhurnë për dhunë familjare, kurse po punohet edhe në krijimin e ekzemplarëve për mbledhjen e të dhënave nga policia, si dhe përpilimi i rregullores. Në pjesën më të madhe konstatohet përparim tek aktivitetet lidhur me MPB-në dhe MD-në, por ekziston mungesë e informacioneve nga MPPS-ja, Angazhimi i katër për “Përforcimin juridik të qytetarëve nëpërmjet informacioneve të qasshme dhe institucioneve të hapura”, kulminoi me analizën e Ligjit për NJP, me ndryshime të përgatitura ligjore në Ligjin për NJP dhe pritet miratimi i tij. Përparim ka edhe në pjesën e ekspertizës, kurse 11 njësi rajonale të MD-së janë fizikisht të arritshme dhe punohet aktivisht që ueb-faqja e MD-së të jetë e qasshme edhe për personat me shikim të dëmtuar, disleksia etj. Në vijim është edhe procedura e përpilimit të planit nacional për përforcim juridik. E gjithë kjo flet se procesi përparon sipas dinamikës së paraparë dhe çon në realizimin e angazhimit. Rekomandohet angazhim më i madh i përfaqësuesve të MPPS-së, me qëllim efikasitet më i madh në partneritet sepse bëhet fjalë për gjendjen e përdoruesve të tyre.

## PASQYRË E PËRGJITHSHME E FUSHËS PRIORITARE

Fusha prioritare “Qasje te drejtësia” e shndërruar nëpërmjet 4 angazhimeve konkret, realizohet sipas dinamikës së paraparë. Grupet e punës funksionojnë me oscilacione dhe sfida të caktuara, por është i dukshëm motivimi i lartë i të gjithë pjesëmarrësve. Kjo u dëshmuar edhe në periudhën e covid-19 kur mbledhjet u mbajtën onlajn, kurse mandej, pas përfundimit të pandemisë, vazhduan me prani fizike. Përgjithësisht bën grupi i punës i angazhimit të dytë, i cili nuk ka mbajtur asnjë takim zyrtar. Megjithatë, pas iniciativës të OJQ “KHAM” Dellçevë, në tetor 2021 u mbajt takim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke u realizuar kështu 70 % e angazhimit. Në këtë mënyrë ky angazhim është në të njëjtin nivel me angazhimet e tjera. Progres ka të gjitha angazhimet dhe ekziston përparim i theksuar në profesionalizimin e kuadrit në strukturat policore, si dhe në strukturat që punojnë në burgjet. Është zmadhuar qasja tek informacionet për viktimat e dhunës familjare nëpërmjet 11 hapësirave policore me pajisje audio dhe video, hapja e procedurave, kurse edhe çdo gjykatë ka gjykatës dezhurn për dhunën familjare. Janë përgatitur një numër i madh aktesh juridike të cilat presin miratim, me të cilat do të përmirësohet dukshëm trajtimi i kategorive vulnerable të qytetarëve. Në këtë mënyrë fitohet gjithnjë dhe më e madhe e institucioneve, është zmadhuar transparenca, duke u siguruar kështu edhe mbrojtje më e madhe e të drejtave të kategorive vulnerable të qytetarëve dhe qasje e tyre te drejtësia.

### TABELA 1.

#### PASQYRË E SHPEJTË

Ky prioritet ekziston nga: tetori i vitit 2021

Periudha e implementimit, që është lëndë e raportimit: 19 shtator 2022

Numri i angazhimeve në suazat e prioritetit: 4

#### ZHVILLIMI I PRIORITETIT

Niveli i hapjes dhe pjesëmarrjes: i kufizuar

Zëri i OQ-ve: ndikim i matur

Përfshirja e institucioneve publike: i kufizuar

#### IMPLEMENTIMI

Angazhime të miratuara: 100 (%)

Angazhime të realizuara tërësisht: 0 (%)

Niveli i bashkëpunimit me OQ-të dhe institucionet publike: i kufizuar

## PESË REKOMANDIME KRYESORE

Ato kanë për qëllim të informojnë zhvillimin e angazhimeve, të cilat janë pjesë e prioritetet që vlerësohet në planin e ardhshëm aksional dhe ta drejtojnë zbatimin e planit aktual aksional. Monitorimi rekomandon si më poshtë:

---

Takime të rregullta të grupeve të punës me qëllim realizim i obligimeve të ndërmarra nga angazhimi.

---

Koordinim më i mirë i anëtarëve të grupeve të punës në këto angazhime.

---

Çdo institucion apo organizatë të propozojë zëvendësim i cili do t'i përfaqësojë reprezentativisht në interes të vazhdimësisë dhe tempit të realizimit të angazhimit.

---

Të bëhet testim a sigurojnë ndryshimet të cilat janë shkaktuar nga aktivitetet e deritanishme në angazhime qasje më të madhe te drejtësia dhe shërbimet më cilësore për grupet qëllimore në terren.

---

Të rekomandohen zëvendësime për anëtarët e partneritetit, nëse angazhimin nuk e shohin si të tyrin por si të imponuar dhe nuk mund t'i përkushtohen.

---

### PËR AUTORIN

**Zoran Bikovski** është sociolog i diplomuar me mbi 20 vjet përvojë në sektorin qytetar, i cili i njeh shkëlqyeshëm sfidat me të cilat ballafaqohen personat në rrezik social. Gjatë karrierës së tij profesionale arritje të veçanta arrin nëpërmjet OJQ "KHAM" Dellçevë dhe si kryetar i Platformës maqedonase për luftë kundër varfërisë. Me angazhimin e vet të njohur në pjesën e avokimit për zgjidhje më të mira ligjore në interes të grupeve të marginalizuara dhe zbatimin e përpiktë të zgjidhjeve ligjore që synojnë kategoritë vulnerable të qytetarëve. Është njohës i shkëlqyeshëm i Ligjit për mbrojtjen sociale, si dhe të Ligjit për kujdesin shëndetësor dhe programet shëndetësore parandaluese. Bikovski ka zhvilluar ekspertizë në zbatimin e metodologjisë "Fuqizimi ligjor dhe llogaridhënia sociale" dhe ka përvojë në mobilizimin e bashkësive dhe avokimin për të drejtat e tyre. Nga kjo rrjedh edhe interesi i tij për zbatimin e fushës prioritare "Qasja te drejtësi", ku është edhe propozues i një prej angazhimeve.





# I. HYRJA

Partneriteti për qeverisje të hapur është iniciativë globale e cila i bashkon reformatorët e pushtetit dhe liderët e shoqërisë qytetare në krijimin e planeve aksionale që pushteti të jetë më inkluziv, më i përgjegjshëm dhe më llogaridhënës. Angazhimet e planit aksional në fushën prioritare “Qasja te drejtësia” mund të mbindërtohen mbi angazhimet ekzistuese, të identifikojnë hapa të rinj për realizimin e reformave aktuale ose të iniciojnë aksion në një fushë krejtësisht të re. Monitorimi i pavarur i angazhuar për përpilimin e këtij raporti zbatoi një sërë aktivitete për vlerësimin e implementimit të angazhimeve që të sigurohet se pushteti do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e tyre. Liderët e shoqërisë qytetare dhe të pushtetit i përdorin këto evalvime që të reflektojnë mbi përparimin personal dhe të përcaktojnë se a ndikojnë aksionet e ndërmarra mbi jetën e njerëzve.

Republika e Maqedonisë së Veriut merr pjesë në PQH nga viti 2011 dhe deri më tani ka miratuar pesë plane aksionale. Plani i pestë aksional (2021 – 2023) e tejkalon ambicien e planeve të mëparshme, sidomos në lidhje me transparencën e prokurimeve publike, dërgimin e shërbimeve publike dhe qasjen te drejtësia për grupet vulnerable. Zbatimi i tërësishëm i planit mund ta bëjë Republikën e Maqedonisë së Veriut lidere rajonale në Ballkanin Perëndimor në fushat kryesore të qeverisjes së hapur dhe t'i adresojë prioritetet e procesit të aderimit në BE. Duke pasur parasysh spektrin dhe vëllimin

e planit aksional, nevojitet bashkëpunim i ngushtë midis institucioneve publike dhe shoqërisë qytetare në arritjen e rezultateve të rëndësishme. Angazhimet e Planit të pestë aksional të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë organizuar në pesë fusha tematike: transparencën, antikorrupsionin, dërgimin e shërbimeve publike, qasjen te drejtësia dhe mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike. Angazhimet mbulojnë një numër të madh temash duke përfshirë edhe prokurimet publike, ndjekjen e paraqitjeve të gjendjes pronësore të funksionarëve publikë, integrimin e prioriteteve qytetare në dërgimin e shërbimeve publike dhe përforcimin e qasjes te ndihma juridike pa pagesë. Republika e Maqedonisë së Veriut po e zbaton edhe planin e saj të dytë për parlament të hapur dhe planin e parë aksional për gjyqësor të hapur për përforcim të transparencës së pushtetit gjyqësor.

Vlerësimin e bën monitoruesi i pavarur Zoran Bikovski nga OJQ “KHAM” Dellçevë, i cili e ka bërë këtë evalvim. Raporti ka për qëllim ta informojë dialogun aktual për zhvillim dhe zbatim të angazhimeve të ardhshme.

Ky raport e përfshin implementimin e angazhimeve në suazat e Qasjes te drejtësia të planit të pestë aksional të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021-2023.

Partneriteti për qeverisje të hapur është iniciativë ndërkombëtare vullnetare e cila synon sigurimin e angazhimeve konkrete nga qeveritë për qytetarët e tyre me




qëllim që të promovohet transparencë, të iniciohet pjesëmarrje qytetare, luftë kundër korrupsionit që të përforcohet qeverisja dhe menaxhimi i mirë. Në vijim është zbatimi i Planit të pestë aksional PQH 2021 - 2023, i cili përmban 5 prioritete kryesore për të cilat tashmë po krijohen politika dhe aktivitete me zbatimin e të cilit do të përparohet efikasiteti në zbatimin e ligjeve në interes të qytetarëve. Duhet të theksohet se kjo është periudhë kur RMV-ja i filloi zyrtarisht negociatat për anëtarësim në BE me mbajtjen e Mbledhjes së parë ndërqeveritare më 19 korrik 2022.

Hapi i parë konkret është Skriningu bilateral. Ai përbëhet nga dy faza:

- 1) sesioni shpjegues dhe
- 2) sesioni bilateral,

ku vendi kandidat e prezanton përgatitjen e vet që ta miratojë dhe ta ndryshojë legjislacionin. Ky është motiv shtesë që ligjet të miratohen me vëmendjen dhe përkushtimin më të madh dhe të zbatohen reformat në administratën publike, me qëllim që të përparohet trajtimi dhe qasja te drejtësia e qytetarëve socialë të rrezikuar dhe e kategorive vulnerabile të qytetarëve.





## II. IMPLEMENTIMI I PLANIT AKSIONAL - QASJA TE DREJTËSIA

### 2.1. PASQYRË E PLANIT AKSIONAL - QASJA TE DREJTËSIA

Me qëllim që të sigurojë mënyrë të sistematizuar të planifikimit dhe zbatimit të procesit të konsultimit, e cila do të sigurojë proces në kohë, pa pengesa, inkluziv dhe transparenten në bashkëkrijimin e PNA 2021 - 2023, në vitin 2020 është përcaktuar mënyra e zbatimit të procesit të bashkëkrijimit të PNA-së, si dhe procedurën për zbatimin e konsultimeve me palët e prekura për krijimin e prioritetëve dhe angazhimeve të reja në suazat e procesit të PQH-së me kornizë kohore, është bërë thirrje publike për bashkëkrijim të PNA 5 dhe janë dhënë drejtimit për zbatimin e pyetësorit për vlerësim të implementimit të masave të PNA-së për PQH 2018-2020 dhe nevojën për përfshirjen e tyre në PAN 5 të ri.

Në mënyrë themelore në procedurë të paraparë dhe përkatëse të procesit të bashkëkrijimit, në shtator 2020, filloi procesi i përgatitjes së Planit të pestë nacional aksional 2021 - 2023 në të cilin, në përputhje me idetë dhe çështjet e reja të dhëna që duhet të përpunohen në këtë plan, u krye fuzion, rigrupim, por edhe zgjerim i spektrit të fushave prioritare për planin e ri aksional, kështu fusha e katërt prioritare e mori emrin: Qasja te drejtësia.

Gjatë zhvillimit të prioritetëve janë përfshirë përfaqësues të institucioneve: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA). Përveç institucioneve, organizatat qytetare që punojnë në këtë fushë janë përfshirë gjithashtu aktivisht në përcaktimin e angazhimeve në suazat e këtij prioriteti. Në përputhje me intervistat dhe konsultimet e kryera me anëtarët e grupeve të punës, nuk pati angazhime të cilat nuk janë pranuar, kurse niveli i bashkëpunimit dhe hapjes së institucioneve dhe organizatave qytetare është i lartë, që dëshmohet edhe nga përkushtimi dhe bashkëpunimi i të gjitha palëve të prekura, jo vetëm në procesin e përcaktimit të angazhimeve por edhe në procesin e zbatimit të tyre.


Fusha prioritare “Qasja te drejtësia” përmban në vetvete katër angazhime dhe në realizimin e tyre janë përfshirë institucionet e prekura nga të cilat varet zbatimi i zgjidhjeve ligjore dhe organizatat qytetare të cilat i përfaqësojnë bashkësitë e marginalizuara. Prosesi ishte i hapur dhe u realizua nëpërmjet takimeve që janë caktuar nga koordinatorët e angazhimeve, ku janë deleguar obligime konkrete. Bashkëpunimi është zhvilluar nëpërmjet dialogut konstruktiv në bazë të argumenteve që ishin prezantuar në përpilimin e angazhimeve dhe janë pranuar që të miratohen zgjidhje në interes të grupeve qëllimore. Të gjitha angazhimet janë pranuar, por nuk janë zbatuar të gjitha me të njëjtin përkushtim. E gjithë kjo kontribuoi

të ketë përparim, të cilin mund ta karakterizojmë si të theksuar dhe nëse vazhdon me tempin e tillë ekziston mundësi objektive që plani të arrihet në afatin e paraparë. Për këtë kontribut serioz japin koordinatorët e angazhimeve dhe përfaqësuesit e institucioneve, të cilët iu qasën me seriozitet procesit dhe e pranuan partneritetin në kuptimin e vërtetë, me vërejtje për përfaqësuesit e MPPS-së, të cilët vijnë në përbërje të ndryshuar ose nuk informojnë për ndryshimet që kanë ndodhur në sektorin e tyre në lidhje me ndryshimet ligjore. Si rezultate të drejtpërdrejta mund t'i theksojmë: Ekziston zmadhim i vëllimit të informacioneve midis nëpunësve policorë dhe në periudhën e aktiviteteve të zbatuara janë trajnuar dhe sensibilizuar 680 nëpunës policorë që të veprojnë me personat përdorues të drogës të cilët kanë shpërndarë njohuritë e marra me kolegët e vet. Është përforcuar kapaciteti i të punësuarve nëpër burgje nëpërmjet trajnimeve përkatëse, kurse janë pranuar edhe 96 persona të rinj me arsim përkatës. Është zmadhuar numri i hapësirave policore në 11 që janë pajisur me pajisje audio dhe video, duke u përmirësuar kështu seriozisht kushtet për punë të avokatëve. Përparim ka edhe në angazhimin e dytë, sepse është përparuar përditësimi i të dhënave të MPPS-së për përmbaruesit, duke u vogëluar theksueshëm numri i konsumatorëve të bllokuar që marrin ndihmë të garantuar minimale. Ekziston një përparim i pjesshëm edhe te angazhimi për gratë që kanë duruar dhunë familjare, janë miratuar shumë akte, pritet vendim i Gjykatës supreme që të mund t'i zbatojë Ministria e Drejtësisë me ligjin e ri. Është realizuar tërësisht emërimi i gjykatësve dezhurnë për dhunë familjare në të gjitha gjykatat themelore, kurse ekziston një përparim i pjesshëm në shpalljen e të dhënave për kryerësit e veprave penale. Përparim i pjesshëm konstatohet edhe te angazhimi i katërt, "Përforcimi juridik i qytetarëve nëpërmjet informacioneve në qasje dhe institucioneve të hapura", nëpërmjet mundësimin të dukshmërisë dhe qasjes te 11 njësitë rajonale të MP të cilat japin NJP, kurse 13 janë me dukshmëri dhe qasje të mesme. Në fazën e përparuar është edhe përpilimi i Planit nacional për përforcim juridik



## 2.2. ANGAZHIME

### I. Përparimi i mbrojtjes së punonjësve seksualë dhe personat që përdorin droga



RAPORTUI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: <b>PO</b>	1. Statusi i implementimit: <b>i kufizuar</b>
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: <b>PO</b>	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: <b>PO</b>

Qëllimi kryesor i këtij angazhimi është sensibilizimi i nëpunësve policorë dhe të punësuarve në burgje në lidhje me veprimin me personat të cilët përdorin droga dhe me punonjësit seksualë nëpërmjet trajnimeve. Personat që përdorin drogë kanë paraqitur shpesh raste se mbi ta është kryer kontroll i paligjshëm nga punonjësit policorë, se janë keqtrajtuar në stacionet policore, se kanë qenë të pasqyruar në torturë (janë obliguar me forcë të pranojnë se kanë kryer vepër që të mund të ngrenë nëpunësit policorë procedurë kundër tyre), veprim çnjerëzor dhe/ose degradues, nuk u janë shqiptuar të drejtat e tyre në stacion policor, mbi ta është përdorur fuqi e jashtë mase policore nga policia në veprimin policor, kursi si pasojë kjo, personat që përdorin droga janë pësuar lëndime trupore. Përveç asaj se personat që përdorin drogë janë të pasqyruar në torturë nga policia, ata janë të pasqyruar në torturë edhe në burgje. Në përputhje me angazhimin janë arritur rezultate të dukshme në pjesën e nëpunësve policorë të trajnuar dhe të sensibilizuar të cilët duhet që ta zbatojnë njohurinë e fituar me qytetarët të cilët përdorin droga dhe t'u drejtohen me fjalor të thjeshtë. Është trajnuar edhe kuadri në institucionet edukuese-korrigjuese, kurse ekziston përparim edhe në profesionalizimin e nëpunësve, sepse ka 96 të punësuar të rinj me arsim përkatës. Është zmadhuar numri i hapësirave policore me pajisje audio dhe video në 11, duke u lehtësuar kështu puna e avokatëve dhe qasje tek informacionet. E gjithë kjo dëshmon se angazhimi është në fazë të theksuar të realizimit. Kështu krijohen kushte për trajtim më të mirë të personave përdorues të drogës në procedurë policore ose në burgje, kurse zmadhohet hapja e pushtetit me qytetarët. Intervista është bërë me koordinatoren e grupit, Susana Novakovska, përfaqësuese e MPB-së, kurse nëpërmjet e-postës janë marrë rregullisht të dhënat e nevojshme për realizimin e angazhimit. Nga koordinatorja është dorëzuar edhe lista e trajnimeve të cilat i kanë kaluar nëpunësit policorë: “Zbatimi i Kodeksit etik për sjelljen e të punësuarve në MPB” (<https://mvr.gov.mk>), “Sfidat bashkëkohore për integritetin policor”, “Bashkëpunimi midis organizatave qytetare dhe institucioneve në zgjidhjen e rasteve të dhunës familjare të bazuar në gjini”, “Sigurimi i shërbimeve senzibile gjinore për mbështetjen e personave që kanë duruar dhunë”, “Puna parandaluese e policisë, respektimi

i të drejtave themelore njerëzore gjatë veprimit policor”, “Përsosja profesionale e nëpunësve policorë për veprimin e tyre profesional dhe ligjor gjatë privimit nga lira, arrestimi përdorimi i mjeteve të detyrimit”, “Identifikimi i fëmijëve viktimë të ekspansionit seksual” dhe “Parandalimi multiprofesional i dhunës gjinore”. Kënaqësi për zbatimin e këtij angazhimi tregon edhe OJQ-ja “HOPS” e cila merr pjesë, gjithashtu, aktivisht në këtë proces dhe është iniciatore e këtij angazhimi. Është bërë intervistë me individuale me Margarita Gligoroskën, si përfaqësuese e sektorit të OJQ-së në angazhim, e cila kishte vetëm fjalë përshëndetëse për procesin, për hapjen dhe përkushtimin e të gjithë anëtarëve të grupit të punës. Nga “HOPS” kishte propozim edhe organizata joqeveritare të jetë pjesë e procesit të trajnimeve dhe ndërtimit të nëpunësve policorë, por kjo kërkesë është refuzuar nga Drejtoria e shqiptimit të sanksioneve me arsyetim se trajnimet tashmë janë përgatitur, përshtatur dhe dihej se kush do t’i zbatojë saktësisht. Koordinatorja e grupit i ka reformuar të gjithë anëtarët për tempin e trajnimeve, kështu që procesi është i hapur dhe secili mund të informohet dhe të përfshihet aktivisht, nëse ka interes

## II. Përparimi i qasjes të drejtësia për qytetarët e rrezikuar socialë dhe qytetarët në rrezik social

RAPORTUI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: <b>JO</b>	1. Statusi i implementimit: <b>i kufizuar</b>
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: <b>PO</b>	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: <b>PO</b>

Për përdorimin e të drejtës së ndihmës minimale të garantuar (NMG) si mjete në të holla nga mbrojtja sociale ose për shndërrim të së drejtës së ndihmës së përhershme në të holla në NMG, ekziston nevojë për dëshim se kërkuesi (ose përdoruesi) nuk mund të sigurojë mirëmbajtje për vetveten në asnjë bazë. Kjo praktikisht nënkupton se nevojitet kërkuesi/përdoruesi të ngrejë padi kundër një anëtari të familjes së vet ose ekonomisë familjare për mirëmbajtje. Problem i dytë i madh për këtë kategori qytetarësh që janë përdorues të NMG-së është mundësia që mjetet që i marrin sipas asaj baze t’u bllokohen nga përmbaruesit për shkak të huas së papaguar. Ligji i përmbarimit i përjashton nga bllokimi përdoruesit e NMG-së, ndihmën humanitare, përfitimet sociale, etj., për të siguruar të ardhura minimale për ekzistencën e familjes gjatë kërkimit aktiv të punës. Por kot, për shkak se numri social nuk është i dukshëm për përmbaruesit, pushtetin lokal dhe bankat. Derisa të “dëshmohet” se bëhet fjalë për fonde të marra nga fusha e mbrojtjes sociale, ka përvoja kur përfituesit e NMG-së ndonjëherë kanë mbetur pa fonde edhe për 6 muaj. Për periudhën që nga fillimi i angazhimit, koordinatori i angazhimit nuk ka konvokuar asnjë takim zyrtar.

Megjithatë, OJQ “KHAM” Dellçevë së pari bëri fushatë për nevojën e së cilës u incizuan 10 video me dëshmitë e familjeve të përdoruesve të NMG-së, të cilët janë bllokuar nga përmbaruesit dhe kanë mbetur pa mjete jetese për një kohë të gjatë. OJQ “KHAM” Dellçevë ka krijuar bazën e të dhënave të OJQ-ve qytetare dhe në të janë regjistruar 126 shfrytëzues të NMG-së të cilët janë bllokuar në periudhën korrik - tetor 2021. Fushata në rrjetet sociale të cilën e ka udhëhequr OJQ “KHAM” ka rezultuar me mbledhjen që u mbajt në Qeveri, në të cilën Oda e Përmbarimit ka marrë përsipër që nëpërmjet një qarkoreje të brendshme të detyrojë përmbaruesit që t'u japin mundësinë personave të bllokuar të japin konfirmimin e statusit të tyre social. Përfaqësuesi nga MPPS-së u angazhua për përditësimin e rregullt të listave të përdoruesve të NMG-së dhe dorëzimin te të gjithë përmbaruesit e regjistruar. Pas takimit, situata është përmirësuar shumë dhe numri i përdoruesve të NMG-së që janë bllokuar është mjaft më i ulët. Megjithatë, që të zgjidhet sfida, nevojitet që Grupi punues i formuar që të realizojë angazhimin të fillojë të funksionojë. Në pjesën e vërtetimit të gjendjes sociale dhe nevojës për padi nuk ka fare dialog, d.m.th. nuk u mbajt asnjë takim zyrtar. Me kërkesën e dorëzuar te koordinatori Mabela Kamberi që të raportojë mbi punën e deritanishme, është kërkuar më shumë kohë dhe se përgjigje duhet të japin shërbimet e MPPS-së. Më 18 shtator 2022, koordinatori i është kërkuar me email të përgjigjet mbi realizimin e aktivitetit të angazhimit, kurse më pas ajo të njëjtën kërkesë ua ka dërguar shërbimeve të MPPS-së, por deri më sot nuk ka asnjë përgjigje. Është kërkuar takim edhe me z. Dushan Tomshiq, i cili është zëvendëskoordinator, por pas dy ricaktimit të takimeve, ka qenë e pamundur të caktohet një takim. Në takimin e shtatorit të vitit 2022 në “Shtëpinë e deputetëve”, të organizuar nga MSHIA-ja, përfaqësuesi i shoqatës “Juristët e rinj” theksoi se deri më tani nuk janë ftuar në asnjë takim. Deri më sot, nuk është marrë asnjë përgjigje nga MPPS-ja. Në lidhje me vetë procesin dhe mosaktivitetin e grupit punues nga angazhimi i dytë, intervista është bërë me Elena Georgievska nga “Shoqata maqedonase e juristëve të rinj”, kurse mendimin e vet e ka dhënë edhe Zoran Bikovski nga OJQ "KHAM" Dellçevë, monitorues i cili përgatit raportin dhe është pjesë e grupit të punës.

### III. Qasja te drejtësia për gratë që kanë duruar dhunë familjare

RAPORTUI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: <b>PO</b>	1. Statusi i implementimit: <b>i kufizuar</b>
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: <b>PO</b>	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: <b>PO</b>

Arsyeja kryesore e angazhimit është se ka mungesë transparence midis institucioneve kompetente që përfshihen në sistemin e mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore ndaj grave që kanë pësuar dhunë në familje, që kontribuon në mbrojtjen joefektive të grave. Nuk ka sistem dhe evidencë të veçantë për rastet e dhunës me bazë gjinore, gjë që e bën të pamundur monitorimin sistematik, përcaktimin e kushteve dhe tendencave dhe planifikimin adekuat të politikave dhe ligjeve për parandalimin dhe mbrojtjen e grave që kanë pësuar dhunë në familje. Si rrjedhim, qëllimi kryesor i angazhimit është krijimi i një regjistri të veçantë për rastet e dhunës në familje nga të gjitha ministritë dhe institucionet kompetente të përfshira në sistemin e mbrojtjes. Zbatimi i angazhimit u realizua me dinamikë të përshpejtuar dhe u mbajtën 12 takime. Është angazhuar edhe një ekspert vendi, i cili ka përgatitur dy akte nënligjore në përputhje me nenet 29 dhe 30 të ligjit. Ato janë dorëzuar në Gjykatën e Lartë dhe janë në pritje të miratimit të tyre, kurse më pas Ministria e Drejtësisë duhet t'i miratojë. Janë filluar disa procese, si procesi i gjenerimit automatik të të dhënave, si dhe të dhëna për veprat penale që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave. Janë mbledhur të dhëna për të kërkuar ndryshime në ligjin e BPP-së, kurse janë emëruar gjykatës dezhurnë në çdo gjykatë për dhunë familjare. E gjithë kjo dëshmon marrëdhënie partneriteti midis të gjithë aktorëve dhe përparimit të rëndësishëm në realizimin e angazhimit. Kjo nga ana tjetër kontribuon në hapjen e të dhënave dhe në transparencën e procedurave dhe mbrojtjen më të madhe të grave në rast të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave. Një pjesë e të dhënave janë mbledhur nëpërmjet intervistës që është bërë me koordinatoren Slavica Zheraiq, kurse një pjesë nëpërmjet plotësimit të tabelave me të dhëna. Për shkak të problemeve shëndetësore, znj. Zheraiq nuk ka mundur të marrë pjesë në intervistë me prezencë fizike, por dy intervista të detajuara janë bërë nëpërmjet telefonit. Koordinatorja foli mbi përkushtimin dhe koordinimin e lartë të grupit punues, por u ankua për mungesën e të dhënave që duhet të ofrohen nga përfaqësuesit e MPPS-së. Si te koordinatori i grupit ashtu edhe te përfaqësuesit e sektorit qytetar ka një ndjenjë se përfaqësuesit e MPPS-së nuk e ndiejnë procesin si të tyre dhe kjo tregohet nëpërmjet mosardhjes së rregullt në mbledhjet dhe sipërfaqësisë në veprimet e tyre. Pas disa shtyrjesh, koordinatori dërgoi zyrtarisht email më 29 shtator 2022 me të cilin kërkoi zyrtarisht nga të gjithë pjesëmarrësit në grupin e punës ta plotësojnë tabelën, sepse të dhënat varen prej tyre. Si edhe në rastin



e mëparshëm, nuk janë marrë të dhënat që nevojiten që të mund të saktësohen gjendjet. Të dhënat për përpilimin e raportit janë marrë nga koordinatori Zheraiq nëpërmjet postës elektronike me tabelë të plotësuar, kurse janë bërë edhe dy intervista nëpërmjet telefonit, në të cilat u shpjeguan të gjitha detajet. Nuk u krye intervistë me prani fizike për shkak të problemeve shëndetësore të koordinatorit. Mandej u bë intervistë nëpërmjet telefonit me Stojan Mishevin nga “ESE”, i cili tregoi gjithashtu, kënaqësi të madhe për përparimin e këtij angazhimi. Mishevi e theksoi hapjen e procesit dhe përkushtimit të të gjitha palëve të përfshira dhe i përsëriti gjetjet dhe gjendjet të cilat i theksoi më parë koordinatori. E theksoi veçanërisht kënaqësinë për përpjekjet për zgjidhje të sfidave me ekspertizë e cila është problem i madh, sidomos në veprat penale, për këtë gjë janë angazhuar ekspertë gjatë gjithë procesit. Si edhe në angazhimet e mëparshme, ekziston një përparim i theksuar në realizimin e këtij angazhimi, por ekziston sfida në përkushtimin e pabarabartë nga të gjitha palët e prekura.

#### IV. Përforcimi juridik i qytetarëve nëpërmjet informacioneve të qasshme dhe institucioneve të hapura

RAPORTUI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: <b>PO</b>	1. Statusi i implementimit: <b>i kufizuar</b>
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: <b>PO</b>	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: <b>PO</b>

Ligji i ri për NJP filloi të zbatohet në tetor të vitit 2019. Nëpërmjet tij u përmirësua shumë qasja te drejtësia, por ai dëshmoi disa dobësi që janë pengesa në realizim. Së pari Byroja për ekspertizë gjyqësore nuk ka mundësi të sigurojë persona të aftë për fushat më të shpeshta juridike për të cilat qytetarët kërkojnë më shpesh NJP, midis të cilave është gjeodezia dhe analiza e ADN-së - biologjia molekulare, problemi i dytë është përmirësimi i ndihmës juridike dytësore për viktimat e veprave të dhunshme penale në përputhje me Kodin Penal dhe i treti është në pjesën e përforcimit juridik dhe shkrim-leximit juridik. Grupi i punës bëri analizë gjithëpërfshirëse, janë mbledhur të gjitha të dhënat dhe drift analiza duhet të ndodhë deri në fund të tetorit që ndryshimi të ndodhë realisht në maj të vitit 2023. U mbajt takim me Byronë për ekspertizë gjyqësore, kurse u lidh edhe marrëveshje me IPSH të cilat bëjnë analizë të ADN-së. Është mundësuar që 11 njësi rajonale të Ministrisë së Drejtësisë të jenë në dispozicion për personat me pengesa fizike dhe ta zmadhojnë dukshmërinë, kurse ekziston edhe përparim edhe te zyrat e tjera. Është krijuar regjistër i ofruesve të ndihmës juridike formale dhe joformale, pritët që të përditësohet dhe pritët të jetë i disponueshëm për publikun. Në përputhje me deklaratën e koordinatorit, takimet mbahen rregullisht, sipas dinamikës së miratuar nga Grupi i punës. Ka përparim të kufizuar dhe pritët që zbatimi i angazhimit të realizohet deri në maj 2023.



Në tetor të vitit 2022 filloi procesi i krijimit të Planit nacional për përforsim juridik. Është përzgjedhur konsultuese e cila do ta lehtësojë të gjithë procesin. Janë zbatuar intervista me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, si dhe me përfaqësues të njërive rajonale të MD-së. Janë mbajtur, gjithashtu, dy fokus grupe me shoqatat që ofrojnë shërbime ligjore dhe paraligjore. Në proces është edhe zhvillimi i Strategjisë nacionale për fuqizimin ligjor, që ka rëndësi thelbësore për ecurinë në zbatimin e angazhimit. Intervista është realizuar me koordinatoren e grupit punues, Arkin Hahijin nga Ministria e Drejtësisë, i cili siguroi të dhënat brenda afatit të dakorduar. Janë bërë dy biseda telefonike dhe informacionet që janë dhënë dhe marrë me postë elektronike dhe janë të detajuara. Gjithashtu, koordinatori dërgoi postë elektronik me të gjithë komunikimin që është bërë me të gjithë anëtarët e grupit të punës. Nëpërmjet kësaj u dëshmuua transparencë dhe hapje maksimale të procesit. Edhe Boris Gudev nga shoqata “Izbor” nga Strumica shprehu kënaqësi nga ritmi i realizimit të angazhimit dhe nga vetë procesi. Gudovi theksoi se kishte periudhë kur janë mbajtur takime edhe dy herë në muaj, të cilat më shpesh kanë qenë onlajn, por kanë qenë të efikase. Kënaqësi të veçantë theksoi nga shpejtësia e Ministrisë së Drejtësisë që ka lejuar proces të hapur, ku janë theksuar dobësitë e ligjit aktual për NJP dhe nevojën për ndryshim të tij, sidomos në ekspertizën e lëndëve. Qëndrimin e tillë e vërtetoi edhe Elena Gerogievaska nga MPPS-ja, e cila theksoi se është bërë analizë e Ligjit për NJP me mbështetje nga përfaqësuesit e Këshillit të Evropës, kurse janë përgatitur edhe propozim-ndryshime për këtë ligj. Në raportin e koordinorit Arkin Jahijit thuhet se në pjesën më të madhe ka progres në pjesën e dukshmërisë dhe efikasitetit të njërive rajonale të MD-së, qëndrim me të cilin nuk janë dakord të gjithë dhe gjendja nuk është e njëjtë kudo. Se procesi ka qenë i hapur dhe inkluziv dëshmon edhe ekipi i FSHHM, i përfaqësuar nga Ivona Stalevska dhe Hristina Vasilevska. Ato dhanë plotësim të tabelës dhe kontributi i tyre fokusohet në përgatitjen e “Planit nacional për përforsim juridik”. Gëzon fakti se mbahet debat nëpërmjet argumenteve dhe në takime u prezantua gjendja faktike e cila flet për pabarazi, sipas shembullit të Prilepit, ku në njësinë rajonale punon një i punësuar, i cili nuk ka të drejtë të vendosë për ndihmë juridike dytësore, kështu që për miratim pritet edhe nga 4 muaj, për dallim nga Tetova ku ka 21 të punësuar. Pikërisht lloji i tillë i debatit flet për hapjen e procesit dhe nëpërmjet fakteve të kërkohej ndryshim i gjendjes, jo vetëm në letër por edhe në terren.



### III. METODOLOGJIA DHE BURIMET



#### **Informacionet për këtë raport janë marrë në bazë të metodologjisë në vijim:**

- zbatim i intervistave individuale me koordinatorët e grupeve të punës për angazhimet
- ndjekje e faqes <https://ovp.gov.mk>, ku mund të gjenden raportet e takimeve të zbatuara
- plotësim i tabelave me të dhëna nga aktivitetet e realizuara nga angazhimet nga koordinatorët e grupeve të punës
- shpallje transparente të tabelës së plotësuar për anëtarët e tjerë të grupeve të punës për komente dhe plotësime të tyre
- komunikim me adresë elektronike me koordinatorët dhe anëtarët e grupeve të punës për angazhimet
- zbatim i intervistave individuale me anëtarët e sektorit qytetar për vlerësimin e tyre mbi procesin e zbatimit të angazhimit
- plotësim i matricës për monitorim
- përpilim i drift-raportit

# ANEKSI I.

## PASQYRË E ZBATIMIT TË “QASJE TE DREJTËSIA”

### Legjenda



**E GJELBËR** = i realizuar (i përfunduar)





**E VERDHË** = në vijim (vetëm nëse ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm dhe angazhimi do të realizohet)



**E KUQE** = angazhim i pafilluar ose i filluar, por nuk ka përparim në implementim

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
4.1.	Përparim i mbrojtjes së punonjësve seksualë dhe personave që përdorin drogë	<p><b>4.1.1.</b> Zmadhim i informacionit ndërmjet punonjësve policorë në drejtim të trajtimit të personave që përdorin drogë dhe punonjësve seksualë duke organizuar trajnime për sensibilizimin e punonjësve policorë.</p> <p><b>1.</b> Zmadhim i informacionit ndërmjet punonjësve policorë në drejtim të trajtimit të personave që përdorin drogë dhe punonjësve seksualë duke organizuar trajnime për sensibilizimin e punonjësve policorë.</p> <p><b>4.1.2.</b> Zmadhim i vëllimit të informacionit midis të punësuarve në burgje në drejtim të trajtimit të personave që përdorin drogë dhe punonjësve seksualë duke organizuar trajnime për sensibilizimin e të punësuarve në burgje.</p> <p><b>4.1.3.</b> Qasje tek informacionet për avokatët dhe të pandehurit nëpërmjet të cilave do të jetë më e lehtë të vërtetohet shkelje e të drejtave të njeriut nëpërmjet futjes së regjistrimit të detyrueshëm audio dhe video në nga një stacion policor në çdo qytet në territorin e RMV – së gjatë marrjes në pyetje, kurse kryesisht në Shkup, Gostivar, Strumicë, Ohër dhe Gjevgjeli</p>	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
4.2.	Përparim i qasjes te drejtësia për qytetarët të rrezikuar socialë dhe qytetarët në rrezik social	<p><b>4.2.1.</b> Përgatitje e udhëzimeve të brendshme qarkore për shfrytëzimin e mundësisë ligjore nga neni 269 paragrafi 1 i Ligjit për mbrojtjen sociale për mbledhjen e të dhënave për gjendjen materiale, financiare dhe pasurore të anëtarëve të familjes/ekonomisë familjare.</p> <p><b>4.2.2.</b> Kapacitete të përforcuara të QPS për përdorim të mundësisë ligjore sipas nenit 298 nga Ligji për mbrojtje sociale</p> <p><b>4.2.3.</b> Përgatitje e udhëzuesit në bazë të aktivitetit nr.2 që përmban bazat për parashtrimet fillestare dhe udhëzime të tjera për rrjedhën e procedurave gjyqësore në interes të QPS-së dhe të përbashkëta me QPS-në</p> <p><b>4.2.4.</b> Krijim i bazës së të dhënave (data - bazë) nga OQ-të për të drejtat e shkelura me bllokim të numrit social</p> <p><b>4.2.5.</b> Xhirim i videove me personat të cilëve u janë bllokuar llogaritë dhe do të flasin për të drejtën e shkelur dhe do të kërkojnë përgjegjësi dhe do të ofrojnë zgjidhje.</p> <p><b>4.2.6.</b> Krijim i zgjidhjes softuerike për llogaritë e marrësve të NMG-së dhe të ardhurave të tjera, që lidhen me numrin social që të mos mundësohet bllokimi i mjeteve nga institucionet.</p>	
4.3.	Qasje te drejtësia për gratë që kanë duruar dhunë familjare	<p><b>4.3.1.</b> Organizim i takimeve të punës për plotësim të rregullores gjyqësore nga MD- ja</p> <p><b>4.3.2.</b> Evidencë e veçantë dhe shpallje kuartale e të dhënave për lëndët gjyqësore mbi dhunën familjare</p> <p><b>4.3.3.</b> Emërimi i gjykatësve dezhurnë në të gjitha gjykatat themelore</p> <p><b>4.3.4.</b> Formim i grupit të punës dhe organizim i takimeve të punës për rishqyrtim dhe plotësim të ekzemplarëve (vepra penale, shkelje dhe ankesa) për mbledhjen e të dhënave nga policia</p> <p><b>4.3.5.</b> Evidencë e veçantë dhe shpallje e të dhënave për propozimet e dorëzuara dhe të tërhequra për vepër penale (n. 130. p. 2);</p>	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
<b>4.3.</b>		<p>Evidencë e veçantë dhe shpallje e të dhënave për shqiptimin dhe zbatimin e masës urgjente për mbrojtje “largim të dhunuesit nga shtëpia dhe ndalim afrimi”</p> <p><b>4.3.6.</b> Organizim i takimeve të punës dhe koordinim me MPB-në, MD-në dhe MSH-në për përgatitjen e ekzemplarit për mbledhjen dhe shpalljen kuartale të të dhënave të ndara për dhunën familjare nga QPS-ja, duke përfshirë edhe të dhëna të detajuara mbi numrin e rasteve ku ka pasur nevojë, numrin e propozimeve të dorëzuara për MPM, numri i propozimeve për ndryshim, ndërprerje apo vazhdim të MPM-së.</p> <p><b>4.3.7.</b> Evidencë e veçantë dhe shpallje kuartale e të dhënave mbi numrin e rasteve të dhunës familjare, si dhe të dhënave të detajuara mbi numrin e propozimeve për shqiptim, ndryshim ose ndërprerje të MPM-së</p> <p><b>4.3.8.</b> Miratim i drejtimeve për shpallje të rregullt të obliguar të të dhënave mbi dhunën familjare nga policia dhe QPS-ja</p> <p><b>4.3.9.</b> Krijim i sistemit elektronik për mbledhje dhe shkëmbim të të dhënave na QPS-ja, gjykatat, policia dhe institucionet shëndetësore, në lidhje me masat e përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare</p>	
<b>4.4.</b>	Përforcimi juridik i informacioneve të qasshme dhe institucioneve të hapura	<p><b>4.4.1.</b> Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për ndihmë juridike pa pagesë në dispozitat 13, 38, 49</p> <p><b>4.4.2.</b> Marrëveshje për bashkëpunim midis Byrosë për ekspertizë gjyqësore dhe ekspertë të tjerë të jashtëm nga fusha e gjeodezisë dhe biologjisë molekulare</p> <p><b>4.4.3.</b> Sesione informative mbi nevojën për ekspertizë në fushat që e prekin qasjen te drejtësia për popullatën me të ardhura të dobëta me Ministrinë e Drejtësisë, BEGJ-in, Odën e avokatëve, institucionet e tjera që duhet të përgatisin ekspertizë.</p> <p><b>4.4.4.</b> Përpilim i udhëzimeve të brendshme (ose alternativë, memorandum midis MD-së dhe BEGJ-it) për veprim nëse nevojitet ekspertizë kur është miratuar ndihmë juridike dytësore.</p>	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
4.4.		<p><b>4.4.5.</b> Analizë me rekomandime afatshkurtra (për zgjidhje momentale urgjente të problemit me ekspertizën dhe zhblokim të lëndëve të cilat janë bllokuar për shkak të saj) dhe rekomandime afatgjata (ndryshime ligjore që në afat të gjata do ta zgjidhin problemin me ekspertizën)</p> <p><b>4.4.6.</b> Krijim dhe mirëmbajtje e regjistrat gjithëpërfshirës publik të qasshëm të ekspertëve nga fushat e interesit të NJP-së.</p> <p><b>4.4.7.</b> Sigurim i qasjes publike dhe dukshmëri e LNJP-së</p> <p><b>4.4.8.</b> “Përshtatje të ueb-faqes së Ministrisë së drejtësisë (ose të <a href="https://pravnapomos.mk/">https://pravnapomos.mk/</a>) për informim pa pengesë në lidhje me LNJP-në (dukshmëri dhe qasje tek informacionet për LNJP dhe PO për personat me disleksion, personat me aftësi të veçantë vizuale dhe auditive, si dhe personat nga bashkësitë etnike)”]</p> <p><b>4.4.9.</b> Bashkim i të dhënave e ueb-faqeve <a href="https://pravnapomos.mk/">https://pravnapomos.mk/</a> и <a href="https://www.pravnozajakni.mk/">https://www.pravnozajakni.mk/</a></p> <p><b>4.4.10.</b> Hartëzim i dhënësve formalë dhe joformalë të ndihmës juridike</p> <p><b>4.4.11.</b> Krijim dhe mirëmbajtje e regjistrat publik në MD mbi dhënësit formalë dhe joformalë të ndihmës juridike</p> <p><b>4.4.12.</b> Bashkim i të dhënave që i posedojnë OQ-të dhe Ministria e Drejtësisë</p> <p><b>4.4.13.</b> Ndërveprueshmëria e bazës ekzistuese së të dhënave (baza e të dhënave), duke mundësuar qasje në drejtësi</p> <p><b>4.4.14.</b> Përgatitje e Planit nacional (strategjisë) për përforsim juridik</p>	

# ANEKSI II.

## BURIME/MATERIALE PËR VERIFIKIM




Për shkak të gjendjes shëndetësore, pushimeve dhe vëllimit të madh të punës, komunikimi me koordinatorët dhe anëtarët e grupeve të punës është bërë me telefon dhe adresë elektronike. Që të kishte transparencë dhe pjesëmarrje, të gjithë anëtarët e grupeve të punës mund t'i shihnin përgjigjet e koordinatorëve të tyre dhe të plotësojnë ose të korrigjojnë.

Të dhënat janë marrë nëpërmjet:

- procesverbaleve të takimeve të mbajtura nga grupet e punës
- informimin narrativ të marrë me të dhëna mbi aktivitetet e zbatuara, që u janë dorëzuar publikisht për komentim anëtarëve të grupit të punës nga koordinatorja Susana Novakovska
- tabela e marrë me të dhëna mbi aktivitetet e zbatuara, që u janë dorëzuar publikisht për komentim anëtarëve të grupit të punës nga koordinatorja Jasna Zheraiq
- tabela e marrë me të dhëna mbi aktivitetet e zbatuara, që u janë dorëzuar publikisht për komentim anëtarëve të grupit të punës nga koordinatori Arkin Jahiji
- korrespondenca me mail me katër koordinatorët e angazhimeve
- korrespondenca me mail me përfaqësueset e FSHHM, Ivona Stalevska dhe Hrisitina Vasilevska
- intervistat telefonike me përfaqësuesit e sektorit OJQ anëtarë të grupeve të punës:
  - A) Margarita Gliguroska – OJQ “HOPS”
  - B) Elena Georgievska – Shoqata maqedonase e juristëve të rinj
  - C) Stojan Mishev – Shoqata “ESE”
  - Ç) Boris Gudev – “Izbor” Strumicë
  - D) Vesna Shaposki – Shoqata “Stanica pet” Prilep
  - DH) Bllagica Kirov – Shoqata “EHO” Shtip

## MATERIALE TË DOBISHME

1. Microsoft Word - for web\_2019-21-Design-Report-Template.docx (opengovpartnership.org)
2. Microsoft Word - for web\_Implementation-Report-2017-19-APs-template\_to-use-updated-12-17-19.docx (opengovpartnership.org)
3. IRM Reports and Analysis (opengovpartnership.org)
4. IRM Guidelines for the Assessment of Minimum Requirements (opengovpartnership.org)
5. NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023-\_-potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf (ovp.gov.mk)



Procesi është mbështetur nga Sekretariati i PQH- së për nevojat e projektit “Mbështetje e procesit të zbatimit dhe ndjekjes së Planit nacional aksional për Partneritet për qeverisje të hapur 2021 - 2023”, të cilin e zbaton Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia në partneritet me Qendrën për komunikime qytetare dhe Shoqatën për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, në bashkëpunim me Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.